



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 258 Prot.

Tiranë, më dt. 26.07.2017

VENDIM

Nr.197, dt. 26.07.2017

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 26.07.2017, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projekt – propozimit për ndryshimet e projektit të rehabilitimit “Sheshit Publik para hyrjes së Portit të Durrësit”, në lidhje me ruajtjen dhe integrimin e strukturave më përfaqësuese të zbuluara gjatë Gërmimit Arkeologjik, të realizuara nga Instituti i Arkeologjisë dhe DRKK Durrës, me subjekt aplikues bashkia Durrës.
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

ARTA DOLLANI